

## Përmbledhje

Bazuar në vlerësimet e Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), BPV-ja reale në TM2 2020 shënoi rënie prej 9.3 përqind. Me rënie janë karakterizuar kryesisht kreditë e reja, eksporti i shërbimeve por edhe shpenzimeve kapitale të qeverisë, ndërsa pavarësisht krizës së pandemisë, remitencat, IHD-të por edhe eksporti i mallrave kanë shënuar rritje.

Në baza tremujore, asetet e sistemit financiar u zgjeruan për 238.2 milionë euro, duke reflektuar kryesisht rritjen e aseteve të sektorit bankar dhe sektorit pensional. Zgjerimi i aseteve të sektorit bankar erdhi kryesisht si rezultat i nivelit të lartë të depozitave të arkëtuara në këtë tremujor, që njëkohësisht paraqet dhe burimin kryesor të financimit të aktivitetit bankar. Kurse, zgjerimi i aseteve të sektorit pensional erdhi si rrjedhojë e kontributeve të arkëtuara dhe kthimit nga investimet gjatë kësaj periudhe. Sektori bankar shënoi ngadalësim të rritjes së aktivitetit kreditues në këtë tremujor, që u reflektua më shumë tek ekonomitë familjare. Po ashtu, edhe niveli i kredive të reja ishte dukshëm më i ulët krahas trendit të periudhave paraprake, si rezultat i efekteve të Covid-19. Sektori bankar shënoi fitim neto në vlerë prej 17.9 milionë euro në këtë tremujor, i cili është më i ulët për 3.4 milionë euro krahasuar me TM2 2019. Kjo erdhi si rrjedhojë e rritjes më të lartë të shpenzimeve kundrejt rritjes më të ngadalësuar të të hyrave të sektorit. Treguesit e shëndetit financiar të sektorit vazhdojnë të jenë në vlera të kënaqshme. Sektori bankar vazhdon të karakterizohet me cilësi të lartë të portfolios kreditore, pra, me nivel të ulët të kredive joperformuese (2.6 përqind në fund të TM2 2020 nga 2.5 përqind në fund të TM2 2019), dhe mbulueshmëri optimale me provizione (prej 134.8 përqind nga 161.2 përqind në fund të TM2 2019). Indikatorët e solvencës (në nivel prej 16.7 përqind) dhe likuiditetit (në nivel prej 36.1 përqind) vazhdojnë të jenë mbi nivelin minimal të rekomanduar me rregullore (prej 12.0 përqind përkatësisht 25.0 përqind).

Sektori pensional u karakterizua me zgjerim të aktivitetit ndikuar nga kthimi pozitiv nga investimet, duke rikuperuar deri në një masë humbjet e shkaktuara gjatë TM1 2020, si dhe nga kontributet e arkëtuara.

Sektori i sigurimeve gjatë tremujorit të dytë të vitit 2020 u karakterizua me zgjerim të aktivitetit, edhe pse në nivel më të ulët. Niveli i primeve të arkëtuara por edhe i dëmeve të ndodhura gjatë kësaj periudhe shënuan rënie, e që ndërlihet me efektin e pandemisë Covid-19. Krahasuar me rezultatet negative financiare në tremujorin e dytë të vitit të kaluar, këtë tremujor sektori rezultoi me fitim, i cili erdhi si rezultat i rënies më të theksuar të nivelit të shpenzimeve krahasuar me rënie më të ngadalësuar të primeve të arkëtuara. Rënia e shpenzimeve u ndikua kryesisht nga masat kufizuese ndaj përhapjes së pandemisë Covid-19.

Sektori mikrofinanciar ka shënuar rritje të aktivitetit gjatë TM2 2020, por që rritja është dukshëm më e ngadalësuar se në periudhat paraprake, ndikuar prej masave parandaluese të marra (mbylljes së ekonomisë) për të luftuar pandeminë Covid-19. Por, sektori mikrofinanciar vazhdon të ketë performancë të kënaqshme dhe cilësi të mirë të portfolios kreditore, edhe pse krahasuar me trendin e periudhave të kaluara këta tregues kanë treguar tendencë rënëse. Në TM2 2020, Qeveria e Kosovës emetoi borxh në vlerë mjaftë të lartë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Emetimi i lartë i borxhit sovran ishte i domosdoshëm pasi që Qeveria e Kosovës gjatë TM2 2020 shënoi rënie të të hyrave buxhetore (si rrjedhojë e pandemisë Covid-19), si dhe nevojës për të përkrahur ekonominë vendore - përmes pakos emergjente fiskale. Vlera e borxhit të emetuar nga Qeveria e Kosovës gjatë TM2 2020 arriti në 162.4 milionë euro. Të gjithë akterët primar në ankandet e letrave me vlerë të Qeverisë së Kosovës, sektori pensional, sektori bankar dhe ai i sigurimeve kanë rritur nivelin e investimeve në këtë instrument gjatë kësaj periudhe (mars 2020 - qershor 2020).

## PËRMBAJTJA

Përmbledhje	-1
Zhvillimet Makroekonomike	-5
Sistemi Financiar	-6
Sektori Bankar	-6
Asetet	-7
Performanca e sektorit bankar	12
Sektori pensional	14
Sektori i sigurimeve	16
Performanca e sektorit të sigurimeve	17
Sektori mikrofinanciar	18
Asetet	18
Performanca e sektorit mikrofinanciar	20
Tregu i letrave me vlerë	22

## GRAFIKËT DHE TABELAT

Figura 1. Vlera e aseteve të sistemit financiar të Kosovës	06
Figura 2. Ndryshimi tremujor në asete të sektorëve përbërës të sistemit financiar	06
Figura 3. Struktura e aseteve të sektorit bankar në tremujorët përkatës	07
Figura 4. Ndryshimi tremujor në stokun e kredive	07
Figura 5. Struktura e kredive sipas veprimtarie ekonomike	08
Figura 6. Kreditë e reja për korporatat jo financiare dhe ekonomitë familjare	08
Figura 7. Struktura e detyrimeve dhe burimeve vetanake	09
Figura 8. Vlera e gjithsej depozitave dhe kategorive kryesore	10
Figura 9. Struktura e depozitave sipas kategorive kryesore	10
Figura 10. Norma e interesit në kredi dhe depozita	11
Figura 11. Norma e interesit në kreditë ndaj korporatave	11
Figura 12. Norma e interesit në kreditë ndaj ekonomive familjare	11
Figura 13. Norma e interesit në depozita	12
Figura 14. Norma e interesit në depozitat e korporatave jofinanciare	12
Figura 15. Norma e interesit në depozitat e ekonomive familjare	12
Figura 16. Profiti dhe treguesit e profitabilitetit të sektorit bankar	13
Figura 17. Treguesit e cilësisë së portofolios kreditore dhe norma e rritjes së KJP-ve	13

Figura 18. Treguesit e solvencës -----	14
Figura 19. Treguesit e likuiditetit -----	14
Figura 20. Asetet e sektorit pensional -----	14
Figura 21. Struktura e aseteve të FKPK-së -----	15
Figura 22. Struktura e aseteve të FSKP-së -----	16
Figura 23. Kthimi në investime dhe performanca e FKPK-së-----	16
Figura 24. Asetet e sektorit të sigurimeve -----	16
Figura 25. Primet e shkruara dhe dëmet e paguara-----	18
Figura 26. Asetet e sektorit mikrofinanciar-----	18
Figura 27. Vlera e kredive ndaj ekonomive familjare dhe korporatave jofinanciare -----	19
Figura 28. Vlera e kredive ndaj korporatave jofinanciare, sipas sektorëve ekonomik -----	20
Figura 29. Vlera e lizingjeve të sektorit mikrofinanciar-----	20
Figura 30. Norma mesatare e interesit në kredi të sektorit mikrofinanciar-----	20
Figura 31. Norma mesatare e interesit në kredi për ndërmarrje, sipas sektorëve ekonomik -----	20
Figura 32. Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit mikrofinanciar -----	21
Figura 33. Treguesit e profitabilitetit të sektorit mikrofinanciar-----	22
Figura 34. Treguesit e kualitetit të portofolios kreditore -----	22
Figura 35. Shuma e borxhit të emetuar-----	22
Figura 36. Shuma e ofruar dhe e emetuar-----	23
Figura 37. Struktura e letrave me vlerë të Qeverisë-----	23
Tabela 1. Treguesit e zgjedhur makroekonomik -----	23

**SHKURTESAT:**

APR	Asetet e Peshuara ndaj Rrezikut
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BPV	Bruto Produkti Vendor
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
CHF	Franku Zviceran
EJL	Evropa Juglindore
EUR	Valuta Euro
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
GBP	Poundi Britanik
IHD	Investimet Huaja Direkte
KJP	Kreditë Jopërfomuese
KMA	Kthimi Mesatar në Asete
KMK	Kthimi Mesatar në Kapital
MF	Ministria e Financave e Republikës së Kosovës
NRER	Norma Reale Efektive e Këmbimit
TMK	Treguesi i Mjaftueshmërisë së Kapitalit
USD	Dollari Amerikan
WEO	World Economic Outlook

## Zhvillimet Makroekonomike<sup>1</sup>

Bazuar në vlerësimet e Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), BPV-ja reale në TM1 2020 shënoi rritje të ngadalësuar prej 1.3 përqind. Dinamikat e zhvillimeve makroekonomike ndryshuan kahje diametralisht në muajt vijues Prill dhe Maj, me shpalljen e gjendjes pandemike dhe ndërmarrjen e masave kufizuese nga Qeveria për të penguar përhapjen e virusit. Sipas ASK-së, aktiviteti ekonomik është karakterizuar me rënie prej 9.3 përqind në TM2 2020. Me rënie janë karakterizuar kryesisht kreditë e reja, eksporti i shërbimeve por edhe shpenzimeve kapitale të qeverisë, ndërsa pavarësisht krizës së pandemisë, remitencat, IHD-të por edhe eksporti i mallrave kanë shënuar rritje.

Çmimet e konsumit shënuan rritje të ngadalësuar prej 0.6 përqind deri në qershor 2020, kryesisht si rezultat i rënies së çmimeve të transportit, rekreacionit, veshmbathjes, por edhe ngadalësimit të rritjes së çmimeve të ushqimit. Inflacioni bazë shënoi rënie prej 0.2 përqind.

Spektori fiskal deri qershor 2020 u karakterizua me rënie të të hyrave buxhetore prej 10.9 përqind dhe rritje të shpenzimeve buxhetore prej 2.2 përqind. Rrjedhimisht, buxheti i Kosovës regjistroi deficit primar buxhetor prej 111.5 milionë euro. Borxhi publik ka arritur në 1.3 miliardë euro, që është për 16.2 përqind më i lartë krahasuar me TM2 2019. Si përqindje e BPV-së, borxhi publik ka arritur në 18.2 përqind, nga 16.5 përqind sa ishte në TM2 2019.

Spektori i jashtëm është karakterizuar me zvogëlim të deficitit të llogarisë rrjedhëse për 19.0 përqind, që kryesisht i atribuohet zvogëlimit të deficitit të mallrave si dhe rritjes së bilancit pozitiv të të ardhurave parësore dhe të ardhurave dytësore. Në anën tjetër, bilanci pozitiv i shërbimeve ishte dukshëm më i ulët. Në kuadër të bilancit të pagesave, remitencat shënuan rritje vjetore prej 7.2 përqind, ndërsa IHD-të shënuan rritje prej 48.7 përqind deri në qershor 2020.

---


<sup>1</sup> Për më shumë informata rreth zhvillimeve makroekonomike referojuni publikimit: Vlerësimi Tremujor i Zhvillimeve Makroekonomike (TM2 2020) i publikuar në faqen e internetit të BQK-së.

## Sistemi Financiar

*Përkundër krizës shëndetësore dhe ekonomike të shkaktuar nga Covid-19, sistemi financiar në vend ruajti ritmin e rritjes së periudhës paraprake. Asetet e sistemit financiar të Kosovës në fund të qershorit 2020 arritën vlerën në 7.41 miliardë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 11.2 përqind (figura 1).*

Zgjerimi i aseteve të sistemit financiar kundrejt periudhës paraprake (qershor 2019), erdhi si rezultat i rritjes së aktivitetit të sektorit bankar (kryesisht mbështetur nga depozitat e arkëtuara) dhe atij pensional (prej kontributeve të arkëtuara dhe kthimit në investime).

Figura 1. Vlera e aseteve të sistemit financiar të Kosovës




Shënim: Të dhënat e paraqitura janë me gjendjen në fund të tremujorit të cekur  
 Burimi: BQK (2020)

Në baza tremujore, asetet e sistemit financiar u zgjeruan për 238.2 milionë euro, kryesisht ndikuar nga asetet e sektorit bankar (+127.1 milionë euro) dhe sektorit pensional (+93.9 milionë euro), dhe në masë më të ulët nga sektorët tjerë (+17.2 milionë euro) (figura 2).

Zgjerimi i aktivitetit të sektorit bankar erdhi kryesisht si rezultat i nivelit të lartë të depozitave të

Figura 2. Ndryshimi tremujor në asete të sektorëve përbërës të sistemit financiar



arkëtuara në këtë tremujor, pas rënies që pësuan në TM1 2020 të ndikuar kryesisht nga efektet e pandemisë Covid-19. Kurse, zgjerimi i sektorit pensional erdhi si rrjedhojë e kontributeve të arkëtuara dhe kthimit nga investimet gjatë kësaj periudhe. Pra, sektori pensional rikuperoi në masë të madhe humbjet prej investimeve të shkaktuara gjatë TM1 2020, si rrjedhojë e efekteve të shkaktuara në tregjet e jashtme nga përhapja e pandemisë Covid-19.


### Sektori Bankar

*Në kuadër të aseteve të sektorit bankar, kreditë u karakterizuan me rritje më të ngadalshme këtë tremujor, përderisa investimet në letra me vlerë u rimëkëmbën. Depozitat, si burimi kryesor i financimit të aktivitetit bankar, u rritën në këtë tremujor, pasuar nga ekuiteti i bankave dhe huazimeve të marra nga sektori i jashtëm. Përkundër rreziqeve të rritura si rezultat i krizës ekonomike e sociale të nxitur nga pandemia Covid-19, sektori bankar vazhdoi të jetë i qëndrueshëm, me cilësi të lartë të portfolios kreditore, nivel të kënaqshëm të likuiditetit dhe mirë i kapitalizuar.*

## Asetet

Vlera e gjithsej asetëve të sektorit bankar në fund të TM2 2020 arriti në 4.85 miliardë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 12.7 përqind. Kurse, në baza tremujore, asetet e sektorit bankar vetëm gjatë TM2 2020 u zgjeruan për 127.1 milionë euro. Si rezultat i përhapjes së pandemisë Covid-19, aktiviteti kreditues i sektorit bankar (që zë peshën më të madhe në kuadër të asetëve të sektorit me pjesëmarrje prej 64.5 përqind) është ngadalësuar (figura 3). Në mungesë të plasimit të mjeteve në formë të kredive, bankat kanë diversifikuar mjetet në zërat tjerë bilancor siç janë depozitat në banka tjera, paraja e gatshme dhe bilanci në BQK, si dhe investimet në letrat me vlerë. Kategoria e bilancit me bankat komerciale shënoi rritje të konsiderueshme, prej 40.9 milionë euro në këtë tremujor, kryesisht si rezultat i afatizimit të mjeteve të deponuara në bankat jashtë vendit. Me rritje u karakterizua edhe kategoria e parasë së gatshme dhe bilancit me BQK (për 11.6 milionë euro), që u ndikua edhe nga rritja e depozitave në këtë tremujor.

Figura 3. Struktura e asetëve të sektorit bankar në tremujorët përkatës




Në këtë tremujor, investimet në letrat me vlerë, u rritën për 3.9 milionë euro krahasuar rënies prej 16.5 milionë euro në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

## Kreditë

Vlera e gjithsej kredive aktive në fund të TM2 2020 arriti në 3.13 miliardë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 6.4 përqind (rritje prej 10.5 përqind në fund të TM2 2019). Për herë të parë në katër vitet e fundit, aktiviteti kreditues u karakterizua me ngadalësim të dinamikës së rritjes nga një rritje dyshifrore në njëshifrore. Kjo dinamikë e rritjes dyshifrore të kreditimit u ndërpre që nga muaji mars 2020, kur edhe filluan masat e para të marra për të luftuar pandeminë Covid-19. Kreditë ndaj korporatave jofinanciare, që përbëjnë 63.6 përqind të gjithsej kredive, shënuan rritje vjetore prej 6.3 përqind (10.7 përqind në periudhën paraprake). Ngjashëm, kreditë ndaj ekonomive familjare pothuajse përgjysmuan ritmin e rritjes së kreditimit krahasuar me periudhën paraprake, prej 6.8 përqind (rritje vjetore prej 10.3 përqind në fund të TM2 2019).


Figura 4. Ndryshimi tremujor në stokun e kredive



Në ngadalësimin e theksuar të kreditimit ndikoi rënia e kredive të reja.

Në TM2 2020, gjithsej kreditë u rritën për 44.2 milionë euro, kundrejt rritjes prej 115.9 milionë euro në TM2 2019. Kreditë ndaj ekonomive familjare shënuan ngadalësim më të theksuar të rritjes, prej vetëm 5.1 milionë euro (37.4 milionë euro më pak se në TM2 2019). Kurse, kreditë ndaj korporatave jofinanciare në TM2 2020 u rritën për 39.7 milionë euro, apo për 32.8 milionë euro më pak krahasuar me TM2 2019. (figura 4).


**Figura 5. Struktura e kredive sipas veprimtarisë ekonomike**



Në aspekt të veprimtarive ekonomike, në baza tremujore, vetëm kreditimi ndaj sektorit të tregtisë shënoi rritje krahas tremujorit paraprak, duke arritur vlerën prej 35.9 milionë euro (19.1 milionë euro në TM2 2019). Rritja e kreditimit ndaj sektorit të tregtisë, ndërlidhet me faktin se tregtia ishte sektori më pak i prekur nga masat kufizuese ndaj përhapjes së Covid-19 (figura 5). Kreditimi ndaj sektorit të ndërtimtarisë, shërbimeve financiare, dhe shërbimeve tjera shënoi rritje më të ngadalësuar vjetore. Ndërsa, kreditimi ndaj sektorit të bujqësisë dhe prodhimtarisë, në TM2 2020 u zvogëlua për 16.9 dhe 8.0 milionë euro,

përkatësisht, krahasuar rritjes prej 0.8 dhe 10.0 milionë euro, përkatësisht në TM2 2019.

**Figura 6. Kreditë e reja për korporatat jo financiare dhe ekonomitë familjare në TM2**



Burimi: BQK (2020)

Kreditë e reja në TM2 2020 shënuan vlerën prej 209.4 milionë euro, që paraqet pothuajse përgjysmim (rënie vjetore prej 47.8 përqind) krahasuar me TM2 2019. Rënia e kredive të reja ishte më e theksuar në muajin prill dhe maj, kurse muaji qershor tregoi shenja të mundshme të rikuperimit të kreditimit. Kreditë e reja ndaj korporatave jofinanciare në TM2 2020 shënuan vlerën prej 134.2 milionë euro, që paraqet rënie vjetore prej 44.2 përqind (figura 6). Rënie më të theksuar vjetore shënuan kreditë me qëllime joinvestuese, prej 63.1 përqind, vlera e të cilave në TM2 2020 ishte 36.1 milionë euro. Kurse, kreditë e reja me qëllime investuese në TM2 2020 shënuan vlerën prej 95.3 milionë euro, një rënie vjetore prej 31.8 përqind krahasuar me TM2 2019. Në aspekt sektorial, i vetmi sektor që u karakterizua me rritje vjetore ishte sektori i bujqësisë, kreditë e reja të së cilit në TM2 2020 u rritën për 1.6 përqind, përkatësisht për 5.4 milionë euro. Kurse, me rënie të theksuar u karakterizuan kreditë e reja ndaj sektorit të industrisë dhe shërbimeve, të cilat u tkurrën për 49.6 dhe 48.6 milionë



euro, përkatësisht, duke shënuar vlerën prej 36.3 dhe 81.7 milionë euro, përkatësisht në TM2 2020.


Me rënie të theksuar u karakterizuan edhe kreditë e reja ndaj ekonomive familjare. Vlera e gjithsej kredive të reja ishte për 85.5 milionë euro më e ulët kundrejt TM2 2019, duke shënuar vlerën prej 75.2 milionë euro në TM2 2020. Prej tyre, kreditë e reja me qëllim konsumi shënuan tkurrjen më të theksuar, prej 71.7 milionë euro krahasuar me TM2 2019, dhe shënuan vlerën prej 49.2 milionë në TM2 2020. Kreditë e reja hipotekare u zvogëluar për 6.3 milionë euro krahasuar me TM2 2019, dhe shënuan vlerën prej 21.3 milionë euro në fund të TM2 2020.

### Detyrimet dhe burimet vetanake

Struktura e detyrimeve dhe burimeve vetanake përbëhet kryesisht prej depozitave (80.5 përqind), stoku i të cilave në fund të muajit qershor 2020 arriti në 3.90 miliardë euro dhe shënoi një rritje vjetore prej 14.0 përqind. Po ashtu, edhe në baza kuartale, gjatë TM2 2020 gjithsej depozitat u zgjeruan për 57.8 milionë euro (figura 7). Kategoria e burimeve vetanake të sektorit u rrit për 28.1 milionë euro në TM2 2020 (-11.8 milionë euro në TM2 2019), si rrjedhojë e fitimit të realizuar gjatë tremujorit të dytë të vitit 2020, dhe mos shpërndarjes së dividendës, sikur kishte ndodhur gjatë TM2 2019. Mos ndarja e dividendëve është një nga masat preventive të marra nga BQK-ja që sektori bankar të jetë sa më mirë i kapitalizuar në këtë kohë kur vendi dhe bota po përballen me pandeminë Covid-19. Në fund të muajit qershor 2020, stoku i gjithsej ekuitetit arriti vlerën prej 570.0 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 12.6 përqind. Në kuadër të kategorive tjera të detyrimeve, borxhi i ndërvarur u zvogëluar për 1.1 milionë euro (+26.9 milionë euro në

TM2 2019), kurse huazimet nga bankat komerciale u rritën për 27.0 milionë euro (+17.4 milionë euro në TM2 2019).

Figura 7. Struktura e detyrimeve dhe burimeve vetanake, ndryshimi tremujor




### Depozitat

Stoku i depozitave në qershor 2020 shënoi rritje vjetore prej 14.0 përqind, e që paraqet rritjen më të lartë vjetore në dhjetë vitet e fundit. Kjo rritje erdhi kryesisht si rezultat i rritjes së nivelit të depozitave të arkëtuara prej ekonomive familjare dhe korporatave tjera financiare (kryesisht fondeve pensionale). Rritje të theksuar gjatë kësaj periudhe shënuan edhe depozitat e arkëtuara prej korporatave publike. Ndërsa, depozitat e arkëtuara prej korporatave jofinanciare, edhe pse kishin kontribut pozitiv, shënuan rritje më të ngadalësuar vjetore.

Krahasuar me ecurinë e depozitave në tremujorin paraprak (TM1 2020), kur ato u karakterizuan me rënie të theksuar (-62.7 milionë euro), në këtë tremujor depozitat shënuan rritje të konsiderueshme. Gjatë TM2 2020, gjithsej depozitat u rritën për 57.8 milionë euro, krahasuar me rritjen prej 41.6 milionë euro në TM2 2019. Depozitat e ekonomive familjare shënuan rritje për 44.5 milionë euro në TM2 2020, duke arritur

vlerën prej 2.65 miliardë euro në fund të periudhës (qershor 2020) (figura 8). Kurse, depozitat e korporatave jofinanciare u zvogëluan gjatë kësaj periudhe, për 8.9 milionë euro në TM2 2020, duke shënuar vlerën prej 650.2 milionë euro në fund të periudhës (qershor 2020). Sipas kategorive të depozitave, depozitat e transferueshme shënuan rritjen më të theksuar, në vlerë prej 29.3 milionë euro (3.6 milionë euro në TM2 2019) në baza tremujore, kurse stoku i tyre arriti vlerën prej 2.34 miliardë euro në fund të periudhës (qershor 2020) (figura 9).

**Figura 8. Vlera e gjithsej depozitave dhe kategorive kryesore gjatë TM2**




Burimi: BQK (2020)

Ndërsa, depozitat e afatizuara dhe ato të kursimit u zgjeruan gjatë këtij tremujori, ndonëse krahas periudhës së njëjtë të vitit paraprak, ato ishin më të ulëta. Vlera e depozitave të afatizuara në baza tremujore u zgjerua për 16.2 milionë euro ndërsa ajo e depozitave të kursimit për 12.4 milionë euro (33.2 milionë euro dhe 4.9 milionë euro përkatësisht në periudhën paraprake). Depozitat e transferueshme vazhdojnë të kenë pjesëmarrjen më të lartë në gjithsej depozitat e sektorit (60.0 përqind), pasuar nga

depozitat e afatizuara (26.8 përqind) dhe të kursimit (13.2 përqind).

**Figura 9. Struktura e depozitave sipas kategorive kryesore, ndryshimi tremujor**



Burimi: BQK (2020)


Vlera e depozitave të reja të arkëtuara gjatë TM2 2020 ishte 67.8 milionë euro, prej të cilave 18.4 milionë euro ishin depozita të arkëtuara nga korporatat jofinanciare, ndërsa 49.3 milionë euro depozita të arkëtuara nga ekonomitë familjare. Kurse, krahasuar me TM2 2019, kemi rënie të theksuar si për ekonomitë familjare (-24.0 milionë euro) ashtu edhe për korporatat jofinanciare (-22.0 milionë euro).

## Normat e Interesit<sup>2</sup>

Norma mesatare e interesit në kredi në TM2 2020 ishte 6.2 përqind, apo 0.3 pikë përqindje më e ulët kundrejt periudhës së njëjtë të vitit paraprak. Ndërsa, norma mesatare e interesit në depozita mbeti në nivel të ngjashëm me periudhën paraprake, në 1.5 përqind në TM2 2020. Rrjedhimisht, margjina në mes të normës së interesit në kredi dhe asaj në depozita qëndroi në 4.7 pikë përqindje (figura 10).

<sup>2</sup> Kalkulimi i normave të interesit: mesatarja tremujore e normave të interesit në kredi, gjegjësisht në depozita. Në tekst ju referohemi si 'normë e interesit'.

Figura 10. Norma e interesit në kredi dhe depozita




Burimi: BQK (2020)

### Normat e interesit në kredi

Norma mesatare e interesit në kredi gjatë TM2 2020 për korporatat jofinanciare ishte 5.9 përqind, apo 0.5 pikë përqindje më e ulët se në vitin paraprak (figura 11).

Figura 11. Normat e interesit në kreditë ndaj korporatave jofinanciare




Burimi: BQK (2020)

Në bazë të kategorive të kredive, norma e interesit për kreditë investive ishte më e ulët (5.7 përqind) krahasuar me normën e interesit për kreditë jo-investive (6.1 përqind). Krahas periudhës së njëjtë të vitit paraprak, vërehet rënie më e theksuar në normën e interesit për kreditë investive (për 0.5 pikë përqindje)

krahasuar me rënien për kreditë joinvestive (për 0.3 pikë përqindje).

Në aspekt sektorial, norma e interesit në kreditë bujqësore shënoi rritje për 0.1 pikë përqindje, dhe arriti në mesataren prej 7.7 përqind. Norma e interesit në kreditë industriale dhe shërbyese shënoi rënie prej 0.5 pikë përqindje, duke arritur në mesataren prej 5.8 përqind, përkatësisht 5.9 përqind.

Figura 12. Normat e interesit në kreditë ndaj ekonomive familjare



Burimi: BQK (2020)


Tek ekonomitë familjare, norma mesatare e interesit në kredi qëndroi në 6.7 përqind, që paraqet një rritje për 0.1 pikë përqindje krahasuar me TM2 2019. Norma më e lartë e interesit ishte për kreditë konsumuese (7.0 përqind), e cila shënoi rritje për 0.3 pikë përqindje krahasuar me TM2 2019. Për më shumë, edhe norma e interesit në kreditë hipotekare shënoi rritje gjatë këtij tremujori (prej 5.7 përqind në TM2 2019 në 6.0 përqind në TM2 2020) (figura 12).

### Normat e interesit në depozita

Norma mesatare e interesit në depozita qëndroi në nivel të ngjashëm krahasuar me periudhën paraprake, në 1.5 përqind (figura 13).


Norma e interesit në depozitat e korporatave jofinanciare gjatë TM2 2020 ishte e ngjashme me atë të ekonomive familjare.

**Figura 13. Norma e interesit në depozita**



Në krahasim me TM2 2019, norma e interesit në depozitat e korporatave jofinanciare shënoi rënie për 0.1 pikë përqindje, duke zbritur në nivelin prej 1.5 përqind. Kjo rënie erdhi si rezultat i zvogëlimit të normës së interesit në depozitat e afatizuara (figura 14).


**Figura 14. Norma e interesit në depozitat e korporatave jofinanciare, sipas kategorive**



Norma e interesit në depozitat e ekonomive familjare shënoi një rritje të lehtë prej 0.2 pikë përqindje krahas TM2 2019, duke arritur në nivel prej 1.5 përqind

(figura 15). Kjo rritje erdhi si rezultat i rritjes së normës në depozitat e afatizuara për 0.2 pikë përqindje. Norma e interesit në depozitat e kursimit ishte në nivel prej 0.3 përqind.

**Figura 15. Norma e interesit në depozitat e ekonomive familjare, sipas kategorive**




### Performanca e sektorit bankar

Sektori bankar në TM2 2020 realizoi profit në vlerë prej 17.9 milionë euro, e që është për 3.4 milionë euro më i ulët krahasuar me TM2 2019 (figura 16). Fitimi më i ulët i realizuar në TM2 2020 ishte si rezultat i rritjes më të lartë të shpenzimeve (për 4.2 milionë euro) krahasuar me rritjen e të hyrave (për 0.8 milionë euro). Të hyrat gjatë këtij tremujori arritën vlerën në 65.5 milionë euro. Të hyrat nga interesi shënuan vlerën prej 49.7 milionë euro (rënie vjetore prej 0.3 milionë euro), që kryesisht janë të hyra nga interesi në kredi. Kurse të hyrat nga jointerеси, të cilat kryesisht janë të hyra nga tarifat dhe komisionet, shënuan vlerën prej 13.8 milionë euro (rënie vjetore prej 0.9 milionë euro). Të hyrat nga rivlerësimi shënuan vlerën prej 2.0 milionë euro në TM2 2020.

Shpenzimet e sektorit bankar shënuan vlerën prej 47.6 milionë euro. Kategoria më e madhe, ajo e shpenzimeve

të përgjithshme dhe administrative shënuan vlerën prej 26.4 milionë euro (për 0.1 milionë euro më e ulët se në TM2 2019). Kategoria e shpenzimeve të jointeredit në TM2 2020 arriti vlerën në 13.2 milionë euro (për 2.1 milionë më shumë se në periudhën paraprake), kryesisht si rrjedhojë e ndarjes më të lartë të shpenzimeve për provizionet për humbjet e mundshme në kredi.

Figura 16. Profiti dhe treguesit e profitabilitetit të sektorit bankar



Kurse, kategoria e shpenzimeve të interesit arriti vlerën në 5.9 milionë euro (për 0.8 milionë euro më shumë se në periudhën paraprake).


Si rrjedhojë e zhvillimeve në të hyrat dhe shpenzimet e sektorit bankar, në TM2 2020 raporti i shpenzimeve ndaj të hyrave ishte në nivel prej 72.7 përqind, apo 5.5 pikë përqindje më i lartë në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Ky raport nënkupton që për çdo 1 euro të arkëtuar sektori bankar shpenzon 0.727 euro (figura 16).

### Treguesit e shëndetit financiar

Treguesit e shëndetit financiar të sektorit bankar vazhdojnë të jenë në nivele të kënaqshme edhe gjatë tremujorit të dytë të vitit 2020, pavarësisht krizës

ekonomike dhe shëndetësore të shkaktuar nga përhapja e pandemisë Covid-19. Treguesit e cilësisë së portfolios kreditore në fund të TM2 2020 qëndruan në nivele të kënaqshme, me nivel të ulët të kredive

Figura 17. Treguesit e cilësisë të portfolios kreditore dhe norma e rritjes së KJP-ve




Shënim: Të dhënat e paraqitura janë me gjendjen në fund të tremujorit të cekur  
Burimi: BQK (2020)

joperformuese (KJP) dhe me mbulueshmëri të lartë të kredive me provizione. Vlera e kredive joperformuese, pas pesë vitesh rënie të vazhdueshme, në qershor 2020 shënoi rritje vjetore prej 10.2 përqind. Mirëpo, norma e kredive joperformuese ndaj gjithsej kredive qëndroi në nivel të ulët, në 2.6 përqind (2.5 përqind në fund të qershorit 2019) (figura 17). Kreditë joperformuese vazhdojnë të jenë mirë të provizionuara, në nivel prej 134.8 përqind (161.2 përqind në fund të qershorit 2019).

Sektori bankar vazhdon të jetë mirë i kapitalizuar dhe i qëndrueshëm. Gjatë kësaj periudhe, treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit ishte në nivel prej 16.7 përqind, nivel ky më i ulët për 1.0 pikë përqindje se sa në periudhën e njëjtë të vitit paraprak (figura 18). Rënia e lehtë e këtij treguesi erdhi si rrjedhojë e rritjes më të ulët të gjithsej kapitalit krahasuar me rritjen më të lartë të aseteve të peshuara me rrezik.

Ndonëse në nivel më të ulët, ky indikator mbetet në nivel të kënaqshëm dhe mbi nivelin minimal të kapitalit rregullator të kërkuar.


Figura 18. Treguesi i solvencës



Shënim: Të dhënat e paraqitura janë me gjendjen në fund të tremujorit të cekur  
Burimi: BQK (2020)

Sa i përket likuiditetit të sektorit bankar, raporti i mjeteve likuide ndaj gjithsej detyrimeve afatshkurtra shënoi rritje të lehtë për 1.0 pikë përqindje krahas gjendjes në fund të TM2 2019, duke qëndruar në nivel prej 36.1 përqind.

Figura 19. Treguesit e likuiditetit



Shënim: Të dhënat e paraqitura janë me gjendjen në fund të tremujorit të cekur  
Burimi: BQK (2020)

Rritja e lehtë e këtij indikator, erdhi si rezultat i rritjes më të përshpejtuar të mjeteve likuide (parasë së gatshme, bilanci me BQK dhe bilanci me bankat tjera) krahasuar me rritjen më të ngadalësuar të detyrimeve afatshkurtëra (kryesisht depozitave pa afat).


Raporti i kredive ndaj depozitave qëndroi në nivel prej 80.1 përqind, që është i përafërt me nivelin e rekomanduar prej 80.0 përqind.

## Sektori pensional

*Sektori pensional u karakterizua me zgjerim të aktivitetit ndikuar nga kthimi pozitiv nga investimet, duke rikuperuar deri në një masë humbjet e shkaktuara gjatë TM1 2020, si dhe kontributet e arkëtuara gjatë këtij tremujori.*

Sektori pensional si sektori i dytë për nga pesha në sistemin financiar, përbën 27.2 përqind të gjithsej aseteve të sistemit financiar. Gjithsej asetet e sektorit pensional shënuan rritje vjetore prej 7.6 përqind duke shënuar vlerën prej 2.01 miliardë euro në fund të TM2 2020. Në baza tremujore, vetëm gjatë TM2 2020, asetet e sektorit pensional u rritën për 93.9 milionë euro (rënie prej 56.6 milionë euro në TM1 2020), kryesisht si rezultat i rikuperimit në masë të madhe të humbjeve nga investimet të shkaktuara gjatë TM1 2020 dhe arkëtimeve nga kontributdhënësit (figura 20).

Figura 20. Asetet e sektorit pensional, ndryshimi tremujor



Burimi: BQK (2020)

Asetet e sektorit pensional përbëhen 99.6 përqind nga asetet e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës


(FKPK) dhe 0.4 përqind nga asetet e Fondit Slloveno-Kosovar të Pensioneve (FSKP). Struktura e aseteve të FKPK-së përbëhet kryesisht nga mjetet e investuara jashtë vendit, por që pesha e tyre krahasuar me periudhën paraprake, shënoi rënie të konsiderueshme. Rreth 69.4 përqind e mjeteve të FKPK-së janë të mbajtura jashtë vendit. Ndërsa, rreth 30.6 përqind e mjeteve janë të investuara brenda vendit, e që krahasuar me gjendjen në fund të TM2 2019, paraqet një rritje për 7.1 pikë përqindje. Pjesa më e madhe e këtyre mjeteve janë të investuara në fletëobligacione dhe bono të thesarit të Qeverisë së Kosovës, të cilat shënuan një rritje të konsiderueshme gjatë TM2 2020 krahasuar me TM2 2019. Kjo rritje erdhi si rezultat i kërkesës së lartë për të emetuar letra me vlerë gjatë kësaj periudhe dhe gatishmërisë së FKPK-së për të investuar mjetet në tregun vendor. Po ashtu, edhe kategoria e mjeteve të deponuara në sektorin bankar ka vazhduar të rritet. Pjesëmarrja e tyre ndaj gjithsej mjeteve të mbajtura në vend ka shënuar rritje të konsiderueshme në këto pesë vitet e fundit, nga 0.5 përqind në fund të TM2 2016, në 9.8 përqind në fund të TM2 2020 (figura 21).

Gjatë këtij tremujori, asetet e FKPK-së u zgjeruan për 93.2 milionë euro, e që kryesisht pasqyron rritjen e investimeve në sektorin e brendshëm. Në kuadër të mjeteve të investuara brenda vendit, në këtë tremujor, rritjen më të lartë e shënuan investimet në letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës (+92.5 milionë euro), pasuar nga kategoria e certifikatave të depozitit (+10.1 milionë euro), përderisa niveli i parasë së mbajtur në BQK u zvogëlua (-36.6 milionë euro). Investimet jashtë vendit, përkatësisht mjetet e alokuara në fondet

investuese u zvogëluan për 239.1 milionë euro, përderisa mjetet në tranzit (që priten të investohen jashtë vendit) shënuan vlerën prej 266.0 milionë euro në këtë tremujor.

Struktura e aseteve të FSPK-së përbëhet kryesisht nga aksionet e investuara jashtë vendit (63.8 përqind), obligacionet e qeverive të huaja dhe të Kosovës (22.9 përqind) dhe aseteve tjera (figura 22). Gjithsej asetet e FSPK-së gjatë TM2 2020 u zgjeruan për 0.8 milionë euro kryesisht si rezultat i rritjes së investimeve jashtë vendit në aksione dhe investimeve në letra me vlerë të Qeverisë së Kosovës.

Figura 21. Struktura e aseteve të FKPK-së (TM2 2020)




Gjatë TM2 2020, edhe FSKP rikuperoi në masë të madhe humbjet nga investimet (-910.0 mijë euro), duke realizuar fitim bruto nga investimet në vlerë prej 677.1 mijë euro (142.7 mijë euro në TM2 2019). Ndërsa, vlera e arkëtimeve të reja nga kontributdhënësit gjatë TM2 2020 arriti në 128.5 mijë euro (132.3 mijë euro në TM2 2019).

Në këtë tremujor, kontributet e arkëtuara të FKPK u shtuan në vlerë prej 42.2 milionë euro, një rënie për 8.5 përqind krahas periudhës së njëjtë të vitit paraprak.

Kjo rënie reflekton vendimet e Qeverisë së Kosovës dhe masat e marra për të luftuar përhapjen e pandemisë Covid-19.


Figura 22. Struktura e aseteve të FSKP-së (TM2 2020)



Burimi: FSKP (2020)

Mbyllja e sektorëve jo-esencial nga gjysma e dytë e muajit mars e deri në fund të muajit maj, me hapjen graduale më pas, dhe masave tjera në fuqi, ka ndikuar që një pjesë e fuqisë punëtore të mos arkëtoj të ardhura, apo edhe të humb vende pune. Kjo dhe u reflektua drejtpërdrejt në nivelin e arkëtimeve të FKPK-së nga kontributdhënësit.

Figura 23. Kthimi në investime dhe performanca e FKPK-së



Burimi: FKPK (2020)


Pas humbjeve të konsiderueshme që FKPK kishte nga investimet jashtë vendit në TM1 2020 (-90.4 milionë euro), tregjet financiare filluan të rikuperoheshin, dhe

FKPK arriti të realizoj fitim rekord në tremujorin e dytë të vitit, në vlerë prej 70.3 milionë euro.

## Sektori i sigurimeve

*Sektori i sigurimeve gjatë tremujorit të dytë të vitit 2020 u karakterizua me zgjerim të aktivitetit, edhe pse në nivel më të ulët. Niveli i primeve të arkëtuara dhe i dëmeve të ndodhura gjatë kësaj periudhe shënoi rënie, e që ndërlidhet me efektin e pandemisë Covid-19. Sektori i sigurimeve gjatë TM2 2020 shënoi profit në nivel të lartë krahasuar me rezultatet negative financiare në tremujorin e dytë të vitit të kaluar.*

Figura 24. Asetet e sektorit të sigurimeve, ndryshimi tremujor



Burimi: BQK (2020)

Asetet e sektorit të sigurimeve deri në fund të muajit qershor 2020 arritën vlerën 208.6 milionë euro, e që paraqet një rritje vjetore prej 9.8 përqind. Kontributin më të lartë në rritjen e aseteve të sektorit e kishte kategoria e depozitave të mbajtura në sektorin bankar, pasuar nga investimet në letrat me vlerë, dhe asetet tjera të prekshme. Në baza tremujore, asetet e sektorit të sigurimeve u rritën për 8.1 milionë euro gjatë TM2 2020 (figura 24). Edhe në baza tremujore, rritja u mundësua kryesisht prej depozitave të mbajtura në



bankat komerciale, pasuar nga asetet tjera të paprekshme, dhe rritja e investimeve në letrat me vlerë.

Ngjashëm me asetet, edhe niveli i përgjithshëm i kapitalizimit të sektorit u karakterizua me rritje. Vetëm gjatë këtij tremujori, gjithsej kapitali shënoi rritje prej 4.3 milionë euro, duke arritur vlerën prej 56.5 milionë euro në fund të periudhës (qershor 2020). Kjo rritje e kapitalit erdhi si rezultat i shtimit të kapitalit aksionar të paguar dhe fitimit të realizuar në këtë periudhë. Megjithatë, niveli i lartë i humbjeve të akumuluar nga vitet e kaluara pati ndikim negativ në rritjen e mëtejme të kapitalit të sektorit të sigurimeve. Sa i përket detyrimeve, ato u karakterizuan me rritje gjatë këtij tremujori (+3.8 milionë euro në TM2 2020), kurse vlera e tyre në fund të qershorit 2020 arriti në 152.2 milionë euro.

Vlera e primeve të shkruara bruto në sektorin e sigurimeve në tremujorin e dytë të vitit 2020 arriti në 23.1 milionë euro, që paraqet një rënie vjetore prej 9.4 përqind (figura 25). Primet e kategorisë 'jo-jetë' përbëjnë 96.3 përqind të gjithsej primeve të shkruara, ndërsa ato të kategorisë 'jetë' 3.7 përqind. Rënia e konsiderueshme e arkëtimeve prej primeve të shkruara reflekton mbylljen e ekonomisë së vendit gjatë periudhës mars-maj, me hapje graduale gjatë muajit qershor, dhe masave tjera aktive për të luftuar përhapjen e pandemisë Covid-19. Si rrjedhojë, vetëm gjatë TM2 2020 sektori i sigurimeve realizoi shitje të policave ('jo-jetë') në numër prej 150.2 mijë sosh, kurse në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar 283.0 mijë.

Ngjashëm me nivelin e primeve të shkruara, edhe dëmet e paguara nga sektori i sigurimeve (përfshirë edhe Byronë Kosovare të Sigurimit) pësuan rënie gjatë këtij tremujori, duke shënuar vlerën prej 9.5 milionë euro, rënie vjetore prej 23.9 përqind (figura 25). Kjo rënie e theksuar e nivelit të dëmeve të arkëtuara reflekton kufizimet në lëvizje të qytetarëve gjatë kësaj periudhe, me theks të veçantë nga gjysma e dytë e muajit mars e deri në fund të muajit maj 2020. Ky kufizim i lëvizjes ka ndikuar në numër më të ulët të aksidenteve të ndodhura, rrjedhimisht edhe vlerë më të ulët të dëmeve të paguara. Si rrjedhojë, raporti dëme / prime gjatë TM2 2020 u përmirësua, duke u zvogëluar në 41.2 përqind nga 49.0 përqind sa ishte gjatë TM2 2019 (figura 25).

### Performanca e sektorit të sigurimeve


Gjatë TM2 2020, sektori i sigurimeve performoi me fitim neto<sup>3</sup> në vlerë prej 3.6 milionë euro (humbje në vlerë prej 1.1 milionë euro në TM2 2019). Fitimi i realizuar në këtë tremujor erdhi si rezultat i rënies më të theksuar të nivelit të shpenzimeve (dëmeve të ndodhura dhe shpenzimeve tjera operative të sektorit) krahas rënies më të ngadalësuar të primeve të arkëtuara. Rënia më e lartë e shpenzimeve është e ndërlidhur me efektet e pandemisë Covid-19, vlera e të cilave ishte më e ulët për shkak të masave për të kufizuar lëvizjen dhe aktivitetet tjera. Kurse, rënia më e ngadalësuar e primeve të shkruara është si rezultat i policave të cilat duhet të ripërtërihen në baza vjetore, siç janë ato kufitare, përgjegjësitë ndaj palës të tretë

<sup>3</sup> Fitimit neto i është larguar fitim/humbja e kompanisë së sigurimit të cilës i është revokuar licenca gjatë vitit të kaluar (2019).

etj., andaj dhe ishin më pak të afektuara nga masat në fuqi për të luftuar pandeminë.

Sa i përket nivelit të likuiditetit, sektori i sigurimeve shënoi përmirësim të ndjeshëm krahasuar me gjendjen që kishte deri në qershor të vitit të kaluar. Raporti i parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj ndaj rezervave teknike, tregon që likuiditeti ka qëndruar në nivel prej 101.8 përqind, për 11.2 pikë përqindje më i lartë se në qershor të vitit 2019. Për më tepër, edhe treguesi tjetër i likuiditetit, raporti i parasë dhe ekuivalentëve të saj ndaj gjithsej detyrimeve, tregon një rritje prej 6.4 pikë përqindje në nivel të sektorit krahasuar me gjendjen deri në qershor 2019, duke arritur në 86.5 përqind në fund të muajit qershor 2020. Kjo rritje ishte si rezultat i rritjes vjetore më të lartë të parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj (prej 13.5 përqind) krahas detyrimeve (5.1 përqind).

Figura 25. Primet e shkruara dhe dëmet e paguara



## Sektori mikrofinanciar


*Sektori mikrofinanciar ka shënuar rritje të aktivitetit gjatë TM2 2020, por që rritja është dukshëm më e ngadalësuar se periudhat paraprake, ndikuar prej masave parandaluese të*

*marra (mbylljes së ekonomisë) për të luftuar pandeminë Covid-19. Megjithatë, sektori mikrofinanciar vazhdon të ketë performancë të kënaqshme dhe cilësi të mirë të portfolios kreditore, edhe pse më të ulët në krahasim me performancën e periudhave paraprake.*

## Asetet

Ritmi i rritjes së asetëve të sektorit mikrofinanciar u ngadalësua për herë të parë në pesë vitet e fundit. Në qershor 2020, vlera e asetëve arriti në 318.7 milionë euro, që paraqet rritje vjetore prej 11.8 përqind. Në baza tremujore, asetet u zgjeruan për 5.0 milionë euro, e në krahasim me TM2 2019, kjo vlerë ishte më e ulët për 12.2 milionë euro. Rritja më e ngadalësuar e asetëve të sektorit gjatë TM2 2020 krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar erdhi si rezultat i efekteve negative në ekonominë vendore të shkaktuara nga pandemia Covid-19.

Figura 26. Asetet e sektorit mikrofinanciar, ndryshimi tremujor




Kjo rezultoi në vlerë më të ulët të huazimeve të marra nga sektori i jashtëm. Hezitimi në plasimin e fondeve u reflektua në rënie të kreditimit, si dhe në rritje të konsiderueshme të parasë së mbajtur në bankat

komerciale. Aktiviteti i lizingjeve shënoi rritje marginale (figura 26).

### Kreditë

Në baza vjetore, gjithsej kreditë shënuan rritje për 7.3 përqind në fund të muajit qershor 2020, dhe stoku i tyre arriti vlerën në 220.6 milionë euro. Krahasuar me periudhën paraprahe, kreditë shënuan ngadalësim të theksuar të rritjes, e cila u reflektua sikur te kreditimi ndaj korporatave jofinanciare, ashtu edhe tek kreditimi ndaj ekonomive familjare. Kreditimi ndaj ekonomive familjare u zgjerua për 8.2 përqind (27.9 përqind rritje vjetore deri në qershor 2019), duke shënuar vlerën prej 150.0 milionë euro në fund të qershorit 2020. Vlera e kredive, në baza tremujore, u zvogëluar për 4.9 milionë euro gjatë TM2 2020 krahasuar me rritjen për 10.8 milionë euro gjatë TM2 2019. Vetëm gjatë TM2 2020, kreditë ndaj ekonomive familjare u zvogëluar për 2.1 milionë euro (figura 27).

Figura 27. Vlera e kredive ndaj ekonomive familjare dhe korporatave jofinanciare, ndryshimi vjetor i kredive



Stoku i kredive ndaj korporatave jofinanciare në fund të qershorit 2020 shënoi vlerën prej 70.6 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 5.4 përqind (rritje vjetore prej 15.8 përqind deri në qershor 2019). Në baza tremujore, gjatë TM2 2020, kreditë ndaj korporatave


jofinanciare u zvogëluar për 2.8 milionë euro (figura 27).

Në aspekt sektorial, vlera e kredive të lëshuara për sektorin e ndërtimitarisë shënoi rritjen më të lartë për periudhën, për 1.6 milionë euro, pasuar nga rritja marginale e kreditimit për sektorin e tregtisë (0.5 milionë euro) gjatë TM2 2020 (figura 28). Kreditimi ndaj sektorit të bujqësisë dhe shërbimeve tjera gjatë kësaj periudhe u karakterizuan me rënien më të lartë, për 1.4 dhe 3.5 milionë euro përkatësisht.

### Lizingjet

Aktiviteti i lizingut në sektorin mikrofinanciar shënoi rritje marginale gjatë TM2 2020 në vlerë prej 0.5 milionë euro, dhe arriti vlerën prej 54.7 milionë euro në fund të periudhës. Kjo rritje u mundësua kryesisht nga lizingu ndaj korporatave jofinanciare, vlera e të cilit u shtua gjatë këtij tremujori për 0.3 milionë euro, dhe arriti në 29.5 milionë euro në fund të periudhës (figura 29).


Figura 28. Vlera e kredive ndaj korporatave jofinanciare, sipas sektorëve të ekonomisë, ndryshimi tremujor



Njëkohësisht, edhe lizingu ndaj ekonomive familjare u shtua për 0.2 milionë euro në TM2 2020, duke rritur

vlerën e përgjithshme në 25.2 milionë euro në fund të periudhës së cekur.

**Figura 29. Vlera e lizingjeve të sektorit mikrofinanciar**




**Normat e Interesit**

Gjatë tremujorit të dytë të vitit 2020, norma mesatare e interesit në kredi ishte 20.3 përqind, normë kjo e ngjashme me periudhën e njëjtë të vitit paraprak (figura 30).

Tek ekonomitë familjare, norma e interesit qëndroi në nivel të ngjashëm me periudhën paraprake, prej 21.3 përqind (figura 30).


**Figura 30. Norma mesatare e interesit në kredi të sektorit mikrofinanciar**



Sipas kategorive të kredive, tek kreditë hipotekare, norma mesatare e interesit krahasuar me periudhën

paraprake, në TM2 2020 u rrit për 0.6 pikë përqindje, në 22.5 përqind. Kurse, tek kreditë konsumuese, norma e interesit ishte e pandryshueshme me periudhën paraprake, prej 20.7 përqind edhe gjatë TM2 2020.

**Figura 31. Norma mesatare e interesit në kredi për ndërmarrje, sipas sektorëve ekonomik**




Për dallim prej ekonomive familjare, tek korporatat jo financiare, norma mesatare e interesit në kredi u rrit lehtësisht. Gjatë TM2 2020, norma mesatare e interesit në kreditë e korporatave jo financiare qëndroi në 17.7 përqind, një rritje për 0.4 pikë përqindje krahasuar me TM2 2019. Në aspekt sektorial, norma më e ulët e interesit në kredi mbeti në sektorin e shërbimeve me 17.3 përqind, por që krahasuar me periudhën paraprake kishte rritjen më lartë, për 4.2 pikë përqindje. Ndërsa norma mesatare për sektorin e bujqësisë pati rënie më të lartë prej 1.9 pikë përqindje duke zbritur në 19.3 përqind. Po ashtu, edhe norma mesatare e interesit për sektorin e industrisë shënoi rënie gjatë kësaj periudhë, për 1.1 pikë përqindje, në 21.0 përqind gjatë TM2 2020 (figura 31).

## Performanca e sektorit mikrofinanciar

Sektori mikrofinanciar edhe pse shënoi nivel më të ulët të të hyrave të arkëtuara, shënoi performancë pozitive financiare edhe gjatë TM2 2020. Të hyrat e sektorit gjatë këtij tremujori shënuan vlerën 10.4 milionë euro, që paraqet një rënie për 4.1 milionë euro krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit të kaluar. Kjo rënie erdhi kryesisht si rezultat i zvogëlimit të të hyrave nga interesi për 3.7 milionë euro, duke zbritur në 9.8 milionë euro gjatë TM2 2020 (figura 32). Të hyrat nga jointerеси u zvogëluan për 0.4 milionë euro gjatë këtij tremujori, duke zbritur vlerën në 0.6 milionë euro, që kryesisht reflekton zvogëlimin e të hyrave nga shërbimet.

Figura 32. Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit mikrofinanciar



Burimi: BQK (2020)

Shpenzimet e sektorit shënuan vlerën 8.5 milionë euro gjatë TM2 2020, vlerë e cila është për 3.8 milionë euro më e ulët se në tremujorin e njëjtë të vitit paraprak. Rënia e shpenzimeve kryesisht reflekton uljen e shpenzimeve nga jointerеси (shpenzimet administrative e të personelit dhe provizioneve për humbjet e mundshme nga kreditë), të cilat u zvogëluan për 2.8 milionë euro, në 5.1 milionë euro gjatë TM2


2020. Po ashtu, rënie shënuan edhe shpenzimet e paguara për interesa dhe shpenzimet tjera operative, por në nivel më të ulët.

Raporti i shpenzimeve ndaj të hyrave, si një indikator i performancës së sektorit, shënoi rënie për 3.0 pikë përqindje krahasuar me periudhën paraprake, duke qëndruar në nivel prej 81.2 përqind në TM2 2020. Kjo do të thotë që për çdo 1 euro të investuar, sektori mikrofinanciar shpenzon rreth 0.812 euro. Rënia më e lartë e të hyrave në krahasim me shpenzimet rezultoi që fitimi neto gjatë këtij tremujori të zvogëlohet për 300 mijë euro krahasuar me TM2 2019, duke zbritur në vlerën 2 milionë euro (figura 33).

Performanca financiare e sektorit u reflektua dhe në dy indikatorët e profitabilitetit, kthimi në mesataren e aseteve (KMA) dhe kthimi në mesataren e kapitalit (KMK), të cilët shënuan rënie prej 0.8 pikë përqindje dhe 3.8 pikë përqindje përkatësisht krahasuar me TM2 2019 (figura 33).

Sa i përket treguesve të kualitetit të portfolios kreditore tek institucionet mikrofinanciare, kreditë jo-performuese vazhduan të qëndrojnë në nivel të ulët dhe patën mbulueshmëri të mirë me provizione.


Figura 33. Treguesit e profitabilitetit të sektorit mikrofinanciar



\*Profiti është anualizuar për tremujorin përkatës  
Burimi: BQK (2020)

Deri në fund të periudhës, kreditë jo-performuese ishin në nivel prej 3.0 përqind, nivel ky më i ulët krahas periudhës së njëjtë të vitit paraprak (3.4 përqind në TM2 2019). Për më shumë, mbulueshmëria e KJP-ve me provizione deri në fund të TM2 2020 ishte 133.5 përqind (figura 34).

Figura 34. Treguesit e kualitetit të portofolios kreditore



Burimi: BQK (2020)


## Tregu i letrave me vlerë

Në TM2 2020, Qeveria e Kosovës emetoi borxh në vlerë mjaftë të lartë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Emetimi i lartë i borxhit sovran ndërlihet me nevojën më të lartë për financim për përkrahje të qytetarëve dhe ekonomisë në kohë të krizës sociale e ekonomike të shkaktuar nga pandemia Covid-19. Njëkohësisht, të hyrat buxhetore pësuan rënie si rrjedhojë e pandemisë, duke rritur nevojën për financim për pakon emergjente fiskale.

Borxhi i emetuar nga Qeveria e Kosovës gjatë TM2 2020 shënoi rritje vjetore prej 47.6 përqind (figura 35). Shuma e borxhit të emetuar gjatë kësaj periudhe arriti në 162.4 milionë euro, ndërsa gjithsej të hyrat për Qeverinë e Kosovës arritën vlerën prej 162.2 milionë euro. Kërkesa për të investuar në letra me vlerë të

Qeverisë së Kosovës vazhdon të tejkalojë ofertën, e që ishte për 1.16 herë më e lartë se sa shuma e kërkuar, por që krahasuar me vitin e kaluar, është më e ulët. Norma mesatare e interesit në letrat me vlerë në TM2 2020 ishte 2.3 përqind, normë kjo më e lartë se në TM2 2019 për 0.7 pikë përqindje (figura 36).


Figura 35. Shuma e borxhit të emetuar, rritja vjetore



Burimi: Ministria e Financave (2020)

Rritja e normës së interesit krahasuar me periudhën paraprake reflekton trendin e emetimit të letrave me vlerë, drejt maturimeve afatgjata. Gjatë TM2 2020, mbi 50.0 përqind e letrave me vlerë të emetuara kishin maturitet mbi pesë vite, kruse gjatë TM2 2019 vetëm 22.7 përqind e letrave me vlerë të emetura kishin maturitet mbi pesë vite.


Figura 36. Shuma e ofruar dhe emetuar



Burimi: Ministria e Financave (2020)

Struktura e letrave me vlerë dominohet nga fletë-obligacionet qeveritare, me maturitet prej 3 viteve, pasuar nga ato me maturitet prej 10 viteve. Krahasuar me tremujorin e dytë të viteve paraprake, gjatë TM2 2020 për herë të parë nuk kemi emetim të bonove të thesarit (maturiteti maksimal i të cilave është 364 ditë) (figura 37). Sektori bankar, fondet pensionale dhe kompanitë e sigurimeve vazhdojnë të jenë të vetmet institucione financiare në vend të cilat vazhdojnë të investojnë në tregun primar të letrave me vlerë të Qeverisë së Kosovës. Krahasuar me gjendjen në fund të TM1 2020, deri në fund të TM2 2020, kemi rritje të investimeve në letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës prej 30.8 përqind (nga sektori pensional), prej 15.1 përqind (nga sektori bankar) dhe rritje prej 8.6 përqind nga sektori i sigurimeve.

Figura 37. Struktura e letrave me vlerë të Qeverisë, në përqindje



Burimi: Ministria e Financave (2020)

**Citimi i sugjeruar i këtij publikimi:**

BQK (2020): Vlerësimi Tremujor i Sistemit Financiar Nr. 31, TM2 2020, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Prishtinë

**Referencat:**

BQK (2020):

- a) Buletini Mujor Statistikor: <http://bqk-kos.org/?id=97>
- b) Statistikat zyrtare të BQK-së, Seritë kohore: <https://bqk-kos.org/?id=55>

ASK (2020):

- a) Indeksi i çmimeve të konsumit: [http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat\\_view/98-cmimet/15-indeksi-i-cmimeve-te-konsumit-](http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat_view/98-cmimet/15-indeksi-i-cmimeve-te-konsumit-)
- b) Indeksi i çmimeve të prodhimit: [http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat\\_view/98-cmimet/79-indeksi-i-cmimeve-te-prodhimit-](http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat_view/98-cmimet/79-indeksi-i-cmimeve-te-prodhimit-)
- c) Indeksi i çmimeve të importit: [http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat\\_view/98-cmimet/80-indeksi-i-cmimeve-te-importit-](http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat_view/98-cmimet/80-indeksi-i-cmimeve-te-importit-)
- d) Reportori Statistikor mbi ndërmarrjet ekonomike: <http://esk.rks-gov.net/regjistri-statistikor-i-bizneseve/publikimet>
- e) Statistikat e tregtisë së jashtme: <http://esk.rks-gov.net/tregtia-e-jashtme/publikimet>
- f) Buletini Tremujor

**Të tjera (2020):**

- a) Shpalljet dhe Rezultatet e ankandëve për letra me vlerë të qeverisë: <https://mf.rks-qov.net/page.aspx?id=1,46>
- b) Fondi Kosovar për Garanci Kreditore: <http://www.fondikgk.org/>
- c) Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës; Raporte tremujore: <http://www.trusti.org/sq/per-ne/raporte/835-2/>

Bloomberg (2020): Metal Prices database.

FAO (2018): World Food Prices, Food and Agriculture Organization of United Nations:  
<http://www.fao.org/worldfoodsituation/foodpricesindex/en/>

Euribor (2020): Euribor Historical Rates:

<http://www.euribor-ebf.eu/euribor-org/euribor-rates.html>

IMF (2020): World Economic Outlook:

<http://www.imf.org/external/pubs/ft/weo/2016/02/weodata/index.aspx>



## Treguesit e zgjedhur makroekonomik

Përshkrimi	Qershor 2019	Qershor 2020
Sektori real 1/		
Bruto Produkti Vendor (BPV) (në milionë euro)	3,245.3	3,073.9
Çmimet e konsumit (mesatarja vjetore)	3.2%	0.6%
Çmimet e konsumit (fondi i periudhës)	2.9%	0.1%
Sektori fiskal 2/		
Të hyrat buxhetore (në milionë euro)	853.5	760.3
Shpenzimet buxhetore (në milionë euro)	853.2	871.8
Bilanci primar (në milionë euro)	0.3	-111.5
Sektori financiar (në milionë euro) 3/		
Asetet e korporatave financiare	6,666.4	7,412.2
prej të cilave: Bankat	4,303.4	4,849.0
Kredi	2,940.0	3,127.4
Depozita	3,425.3	3,903.2
Norma e interesit në kredi, fondi i periudhës	6.3%	6.3%
Norma e interesit në depozita, fondi i periudhës	1.3%	1.5%
Hendeku i normës së interesit	5.1%	4.7%
Sektori i jashtëm, (në milionë euro) 3/		
Bilanci i pagesave		
Llogaria rrjedhëse dhe kapitale	-294.3	-227.8
prej të cilave: remitencat e pranuar	405.6	434.9
Llogaria financiare	-145.1	-284.1
Investimet e huaj direkte në Kosovë	110.8	164.7
Investimet portfolio, net	-31.7	-388.9
Investimet tjera, net	-260.9	214.3
Pozicioni ndërkombëtar i investimeve (PNI), net	-462.4	-709.7
Asetet	4,912.3	5,076.3
Detyrimet	5,374.7	5,786.1
Borxhi i jashtëm, gjithsej	2,155.0	2,273.0
Borxhi i jashtëm privat	1,663.2	1,754.4
Borxhi i jashtëm publik	491.7	518.6

Burimi:

1/ ASK (2020);

2/ MF (2020);

3/ BQK (2020).

